



Konferenca e VI Ndërkombëtare Infermierore

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Departamenti i Infermieristikës, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, organizoi në kuadër të Muajit të Infermierit "KNIS 2022-KONFERENCËN E VI NDËRKOMBËTARE INFERMIERORE NË SPECIALITETE" në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Departamentin e Infermierisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Urdhrit e Infermierit të Shqipërisë, Universitetin e L'Aquila-s dhe Universitetin e Barit "Aldo Moro", Itali," në datat 19-20 maj 2022, që përkuan me Muajin e Infermierit. Në këtë konferencë morën pjesë me fjalën e tyre përshëndetëse, Zëvendësministria e Arsimit dhe Sportit Albana Tole, profesorët e nderuar nga Universiteti i L'Aquila, Maria Grazia Cifone, Maurizio Giuliani, Vittorio Calvisi, Mario Giannone dhe profesorët nga Universiteti i Barit, Gaetano Dammacco, Luigi Santacroce, Raffaele Palmirotta dhe Antonio Mazzocca, Drejtor i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore të Shqipërisë, Dr. Skënder Brataj, Presidentja e Urdhrit të Infermierit Blerina Duka, anëtar i Komisionit parlamentar të Shëndetësisë Florenc Spaho dhe autoritete të tjera drejtuese të institucioneve shëndetësore. Profesionistë të shëndetësisë, kërkues, akademikë dhe studentë morën pjesë në këtë aktivitet me punimet e tyre shkencore për dy dite me radhë. Ky aktivitet shkencor e arriti qëllimin e tij me disa bashkëpunime, duke krijuar një mjedis mjaft aktiv me diskutime konstruktive dhe plot risi në shëndetësi. Aktiviteti është i akredituar nga QKEV, për profesionistët e shëndetësisë me 7.5 kredite për pjesëmarrësit pasivë dhe 15 kredite për lektorët. Konferenca u organizua nën kujdesin e veçantë të Rektorit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Prof. dr. Skender Topi.

Prof.dr. Skender Topi, takim zyrtar në Universitetin e Firences



Rektori i Universitetit të Elbasanit, Prof.dr. Skender Topi, zhvillon një takim zyrtar me Rektoren e Universitetit të Firence, Prof. Alessandra Petrucci. Takimi u zhvillua në rektoratin e Universitetit të Firence me në fokus, zgjerimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve. Pjesë e dakordësisë u bë iniciativa për organizimin e një programi të përbashkët studimi në fushën e shkencave sociale. Gjithashtu palët shprehën dakordësinë për të zgjeruar bashkëpunimin në kuadër të programit Erasmus+ për programet e studimit në ekonomi, drejtësi dhe shkencë mjekësore teknike.

Fuqizimi i grave dhe vajzave në STEM dhe kërkimi shkencor



Shoqata "Për Gratë Fëmijët", në bashkëpunim me AKKSHI, prezantoi në ambientet e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", projektin "Equality Network-Fuqizimi i grave dhe vajzave në STEM dhe kërkimi shkencor". Znj.Nora Malaj, Znj.Ermira Pirdeni, Znj.Flutura Xhabija dhe Znj.Rajmonda Prifti, në kumtesat e tyre, theksuan se promovimi i pakët mediatik, mungesa e modeleve apo shëmbujve për tu ndjekur, paragjykimet shoqërore, kanë krijuar një hendek për zhvillimin e grave dhe vajzave në fusha të ndryshme, sidomos atë të kërkimit shkencor.

Profesorë të ftuar në UE



Në kuadër të bashkëpunimit disaveçar me Universitetin Aldo Moro, Bari, Itali, kemi këtë javë lektor të ftuar në Departamentin e Shkencave Sociale dhe Edukimit Qytetar, Prof. Gaetano Dammacco dhe Prof. Roberta Santoro të cilët po zhvillojnë leksion me studentët e programeve të studimit të këtij departamenti.



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me AADF në Programin Research Expertise from the Academic Diaspora READ. Në takim morën pjesë kryetari i BoT AADF, z. Michael D. Granoff, bashkëpunëtorët e AADF, z. Martin Mata dhe z. Aleksandër Sarapuli, ministria e Arsimit dhe Sportit, znj. Evis Kushi, anëtarë nga Këshillat Këshillimor të Programit READ, si dhe përfaqësues nga Institucionet e Arsimit të Lartë në të gjithë vendin. AADF, synon të sjellë deri në 100 studiues të Diasporës Shqiptare për të punuar me institucionet e Arsimit të lartë në Shqipëri, në projekte kërkimore bashkëpunuese, doktoratë, supervizim, zhvillim i kurrikulës dhe bashkë-mësimdhënie.

Të jesh bankier i suksesshëm



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit, kanë organizuar pranë Fakultetit Ekonomik, aktivitetin me temë "Të jesh bankier i suksesshëm", prezantuar nga Z.Erion Qosja, Këshillues Biznesi pranë Credins Bank, Dega Elbasan. Në prezantimin e tij, Z.Qosja u ndal në sistemin bankar, shërbimet bankare, roli dhe funksioni i bankierit, cilësitë dhe aftësitë që duhet të ketë në punën e tij. Ky aktivitet mbylli siparin e një sërë aktivitetesh promovuese për studentët që Zyra e Këshillimit të Karrierës, ka zhvilluar përgjatë këtij viti akademik, në bashkëpunim me Bordin Këshillimor të Biznesit.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi



Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit midis Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Marrëveshja ka për qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta, hulumtimeve, ngritjen e kapaciteteve të ekipeve profesionale të palëve, si dhe për mbështetje të ndërsjellë gjatë realizimit të aktiviteteve të përbashkëta.

"Kujtesa Kolektive në Letërsi dhe Media"



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani, u organizua Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë "Kujtesa Kolektive në Letërsi dhe Media". Qëllimi i kësaj konference është të paraqesë këndvështrime të reja mbi dilemat tradicionale që lidhen me kujtesa kolektive, veçanërisht në fushën e letërsisë dhe medias. Konferenca është një përpjekje për të promovuar kërkimin shkencor dhe për të adresuar pyetje që lidhen me rëndësinë dhe rolin e letërsisë dhe medias në formësimin e kujtesës kolektive dhe rimodelimin politik, social dhe realitetet kulturore.

Seminar informues



Në Rektoratin e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" u organizua seminari informues në lidhje me praktikën e përpunimit dhe dorëzimit të dokumentave në DPA, për punonjësit e sekretari-arkivave. Të pranishëm në këtë seminar ishin dhe 2 përfaqësuesit e DPA inspektorët Znj. Enkelejda Sejđini dhe Z.Liman Qyra, të cilët me eksperiencën e tyre në këtë fushë, informuan punonjësit e sekretari-arkivave, për procedurën e përpunimit dhe dorëzimit të dokumentave në DPA, sipas udhëzimeve të kësaj drejtorie.

Ligjeratë "Hebrenjtë dhe shpëtimi i tyre nga shqiptarët"



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", është zhvilluar një ligjeratë me titull "Hebrenjtë dhe shpëtimi i tyre nga shqiptarët", nga profesori i historisë së letërsisë hebreje në Universitetin Hebraik të Jeruzalemit, Z.Yitzhak Kerem. Në ligjeratën e tij Prof.Kerem, ndau me studentët fakte historike mbi emigrimin e hebrenjve përgjatë historisë, kontributin që ka dhënë populli shqiptar për hebrenjtë gjatë Holokaustit dhe bashkëpunimi i nevojshëm, për të parandaluar apo penguar përsëritjen e genocidit të karakterit të përngjashmëm me situatën që po zhvillohet në Ukrainë.